



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1150/2 prot.

Tiranë, më 22 . 08 . 2022

V E N D I M

Nr. 167, datë 22 . 08 . 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, është paraqitur ankesa nr. 124 Regj., datë 17.08.2022, e shtetas M. L, kundër Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK) Shkodër, me pretendim diskriminimin për “çdo shkak tjetër”².

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, ka parashtruar se: “Kam qenë e punësuar në pozicionin e Drejtoreshës pranë Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK) Shkodër, nga data 24.12.2014 deri më datë 20.10.2021.

Me datë 22.06.2022 i jam drejtuar zyrtarisht edhe nëpërmjet postës elektronike, DRTK Shkodër, që të më lëshojë një vërtetim page (për periudhën kur kam qenë e punësuar në atë institucion) për arsye dokumentacioni, dhe deri më sot, me datë 11.08.2022, ky institucion nuk më është përgjigjur zyrtarisht, duke shkelur në mënyrë flagrante ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e

¹ Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

² Ankuesja ka shënuar “çdo shkak tjetër” tek lista me shkaqet e pretenduara të diskriminimit, në formularin e ankesës pranë KMD-së, duke cilësuar se referon tek ky shkak funksionin që mbante më përpara në DRTK Shkodër.

Informimit” dhe duke më diskriminuar për shkak të funksionit të mëparshëm që kisha në atë institucion.

Bazuar në ligjin sipërcituar, institucioni duhet të më ishte përgjigjur deri tani dhe kjo mungesë trajtimi e kërkesës time prej një muaji e gjysëm është refuzim i përsëritur... kjo është një kundravajtje administrative nga ana e DRTK Shkodër, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Subjekti ankues ka pretenduar se moskthimi i përgjigjes nga ana e DRTK Shkodër është i qëllimshëm dhe përbën një sjellje diskriminuese, pasi i është shkelur një e drejtë që i takon me ligj. Lidhur me këtë problematikë, ankuesja shprehet se ka informuar edhe Kryeministrin, pasi kjo qasje ndaj qytetarëve nga ana e DRTK Shkodër është e patolerueshme.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit nga ana e DRTK Shkodër, lidhur me refuzimin e dhënies së informacionit të kërkuar nga ana e saj.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata

ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

Pretendimi i M. L lidhet me refuzimin e DRTK Shkodër për t’iu përgjigjur zyrtarisht si dhe për t’i vënë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar prej saj, vërtetimin e pagës lidhur me periudhën kur ajo ishte e punësuar pranë këtij institucioni.

Komisioneri vëren se, sikurse edhe vetë ankuesja është shprehur, mosveprimi institucional i DRTK Shkodër ka të bëjë me moszbatimin e shkeljen e dispozitave ligjore të ligjit nr. 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”*, të ndryshuar, dhe kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të përcaktuara shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Komisioneri vlerëson se, lidhur me pretendimin e ankueses, se institucioni sipërcituar, nuk i është përgjigjur kërkesave të saj; autoriteti mbikëqyrës i pavarur për zbatimin e ligjit nr. 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”*, të ndryshuar, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, është institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Bazuar në nenin 24³, të këtij Ligji, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, shqyrton kërkesat e personave, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në ligjin *“Për të Drejtën e Informimit”*, të ndryshuar.

³ “Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative. Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit. Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit, e cila, verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim,

Referuar rastit konkret, bazuar në nenin 23⁴, pika 1 dhe 2 e Kushtetutës, Komisioneri thekson se, e drejta e informimit është një e drejtë kushtetuese e si e tillë është e garantuar dhe se kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore.

Ky parim përshkon edhe nenin 48 të Kushtetutës sipas të cilit “*Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t’u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj*”.

Komisioneri sjell në vëmendje se, informacioni i kërkuar nga subjekti ankues apo çdo subjekt tjetër i ndodhur në kushte të njëjta, është një informacion i cili i duhet dhënë personit, bazuar në parashikimet ligjore të nenit 6, të Kodit të Procedurës Administrative (KPA), të ndryshuar, “*Parimi i informimit*”, i cili përcakton se: “*Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit*”.

Ligji nr. 45/2022 “*Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për Aksesin në Dokumentet Zyrtare*”, në nenin 2⁵, të tij cakton Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si institucionin përfaqësues në Këshillin e Palëve, duke përcaktura këtë Institucion edhe si Institucionin monitorues e zbatues të dispozitave të kësaj Konvente.

Neni 2⁶, i kësaj Konvente ka përcaktuar se: “*1. Secila Palë duhet të garantojë të drejtën e çdo personi, pa u diskriminuar për ndonjë shkak, për të pasur akses, me kërkesë, në dokumente zyrtare që mbahen nga autoritetet publike. 2. Secila Palë duhet të marrë masat e nevojshme në të*

ai mund t’u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, Komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi. Në qoftë se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit të parashikuar në pikën 4, të këtij neni, ankuesit i lind e drejta për t’iu drejtuar gjykatës. Procedura administrative e parashikuar në këtë nen nuk çënon kompetencat e Avokatit të Popullit, lidhur me mbikëqyrjen dhe zbatimin e të drejtave civile, sipas ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”.

⁴“ 1. E drejta e informimit është e garantuar. 2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore”.

⁵ “Në përputhje me nenin 12, pika 1, të Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare”, Republika e Shqipërisë cakton Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si përfaqësues në Këshillin e Palëve”.

⁶ “E drejta për akses në dokumente zyrtare”.

drejtën e vet kombëtare, për zbatimin e dispozitave për akses në dokumente zyrtare të përcaktuara në këtë Konventë”.

E drejta e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, është objekt i rregullimit ligjor të parashkuar në ligjin nr. 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”*, të ndryshuar.

Pika 3 e nenit 3, të këtij ligji, sanksionon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit”.*

Po ashtu, pika 2, e nenit 2, të tij, përcakton se: *“Informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”.*

Bazuar në parashikimet e ligjit nr. 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”*, të ndryshuar, kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. E drejta e informimit u krijon akses qytetarëve në dokumente zyrtarë dhe ndihmon personat, interesat e të cilëve preken nga vendimmarrje të mundshme administrative, duke u njohur me vendimmarrjet por edhe me procedurën e ankimit. Institucionet publike kanë detyrimin të jenë pro-aktiv në informimin e qytetarëve dhe të aktorëve të interesit.

Komisioneri, vëren se, çdo person, kur vlerëson se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ligji 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”*, të ndryshuar, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si Institucioni dhe organi kompetent i krijuar me ligj të posaçëm.

Ankimi bëhet në rastet kur subjekti juridik, institucioni:

- refuzon dhënien e informacionit;
- nuk përgjigjet;
- kthen përgjigje pa vënë në dispozicion dokumentin e kërkuar;
- kthen përgjigje të paplotë.

Ankimimi pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda afateve ligjore të përcaktuara në këtë Ligj, dhe mosrespektimi i dispozitave të tij nga cilido subjekt juridik, sjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në nenin 18 të këtij Ligji.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përfundim të shqyrtimit të ankesës së subjektit ankues, vendos bazuar në dispozitat e Ligjit të posaçëm, për urdhërimin e autoritetit publik për të dhënë informacionin e kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme brenda një afati të caktuar. Në rast se autoriteti nuk jep sërish informacion, Komisioneri ka të drejtë të përcaktojë përgjegjësinë direkte dhe gjobën për titullarin e autoritetit publik, koordinatorin e të drejtës së informimit, apo çdo nëpunës të autoritetit, i cili ka penguar plotësimin e kërkesës tuaj. Kërkuesi ose autoriteti publik ka të drejtë ta ankimojë vendimin e Komisionerit në gjykatën administrative kompetente.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e ankesës së shteteases M. L, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁷.

Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b)është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë kërkimet e ankueses për të shqyrtuar sa më sipër, nuk pranohen.

Për sa më sipër, subjekti ankues mund t'i drejtohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së informimit.

- Lidhur me pretendimin e ankueses për diskriminim *“për çdo shkak tjetër”*.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh⁸. Neni 1, i ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh⁹.

⁷ Për analogji citojmë Vendimin nr. 231, datë 25.11.2021 dhe Vendimin nr. 256, datë 29.12.2021, të KMD-së.

⁸ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”*

⁹ Neni 14, I KEDNJ-së: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”*.

Krahas praktikës kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Referuar përmbajtjes së nenit 1 të LMD-së, rezulton tepër e qartë dhe evidente, që të gjitha shkaqet e përmendura, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me cilësi, apo karakteristika individuale të personave që pretendojnë për diskriminim. Situata diskriminuese në vetvehte është gjithmonë e lidhur me një veçori individuale të viktimës dhe në rastin konkret, subjekti ankues nuk ka identifikuar një shkak të vlefshëm diskriminimi, që të ketë lidhje me një nga karakteristikat personale të përcaktuara në LMD.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Në bazë të nenit 7, të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”, duke cilësuar këtu funksionin e mëparshëm që kishte patur në këtë institucion. Komisioneri vëren se, funksioni i mëparshëm i ankueses në marrëdhëniet e punës me insitucionin, nuk përbën shkak në vetvete në kuptim të LMD-së. Ai ishte një funksion në kuadër të marrëdhënieve të punës dhe nuk lidhet me një cilësi personale të ankueses e cila të ketë shërbyer për ta diferencuar atë apo trajtuar ndryshe nga personat e tjerë që kanë kërkuar të njëjtin shërbim, informacion, dokumentacion nga institucioni.

Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument, indicie apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë shkakut specifik, duke mos arritur të identifikojë se posedon cilësi apo karakteristikë personale, të identifikueshme, mbi bazën e të cilave të kishte ardhur trajtimi i tij i pabarabartë krahasuar me individët e tjerë, në kuptim të gëzimit e justifikimit të shkakut të mbrojtur sipas LMD-së.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, i cili citon se “*Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim*”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/ç, të ligjit nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues M. L, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime

Shkaku: Çdo shkak tjetër

Lloji i vendimit: Mospranim